2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sherbim / muaj	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	Afati
1	Mirëmbajtje e sistemit AMI	1 / 24			24 Muaj
Çmimi total				_____	
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Sipas termave të referencës

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **Mirëmbajtje e sistemit AMI për një periudhë dy vjeçare**

Detyrat: Sipas Specifikimeve

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

ANEKSI 2: TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Mirëmbajtje e sistemit AMI për një periudhë dy vjeçare”:**

Përmbajtje

1.	Hyrje.....	27
1.1	Qëllimi i shërbimit	27
2.	ANALIZA E SISTEMIT	27
2.1	Setup-i i sistemit	28
2.2	Analiza.....	28
2.3	Mbledhja e të dhënave.....	29
2.4	Komunikimi.....	29
3.	OBJEKTIVAT DHE REZULTATET QE DUHET TE ARRIHEN	29
4.	SUPOZIMET DHE RISQET	30
4.1	Supozimet.....	30
4.2	Risqet.....	30
5.	LOGJISTIKA DHE KOHA	30
5.1	Vendndodhja	30
5.2	Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave	30

6. RAPORTIMI.....	30
7.NIVELET E SHERBIMIT(SLA).....	31
7.1 Koha e ofrimit te sherbimit (SLA).....	31

1. Hyrje

Sistemi i AMI është një sistem kompleks, i cili përfshin Software për menaxhimin on line të të dhënave të matuara të Energjisë Elektrike, matësa energjie smart të standartit EDM I ATLAS Mk10E dhe EDM I ATLAS Mk6E si dhe Pajisje IT Hardware. Ky sistem është ndërtuar për nevojat e OSHEE sh.a. që t'i përgjigjet kërkesave të tregut për automatizimin e matjes së konsumit dhe prodhimit të energjisë elektrike por edhe në funksion të kërkesave të tregut të lirë të energjisë elektrike

Sistemi AMI është një platformë e bazuar në një grup aplikacionesh të ndërlidhura mes tyre për të ofruar:

- Mbledhje dhe ruajtje e të dhënave nga pikat e matjes fundore në mënyrë automatike dhe të centralizuar.
- Shpërndarjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme tek strukturat përkatëse të OSSH Sh.A. si edhe tek përdoruesit fundor.
- Gjenerimin e raporteve mbi konsumin.
- Monitorimin në kohë reale të parametrave të enegjise elektrike, dhe cilësisë së energjise elektrike.
- Menaxhimin e kohës së ndërprejeve të energjisë (outage management).
- Menaxhimin e ngarkesës (load management), devijimeve të vlerave nominale të tensionit, etj.
- Mundësi për kryerjen e bilancit energjitik të një nyje të caktuar të sistemit në kohe reale.
- Mundësi për zbulimin e tentativave të cënimit të sistemeve të matjes në kohë reale.
- Parametrizime dhe konfigurime të sistemeve të matjes në distancë.
- Mundësi konfigurimi të disa tarifave.

1.1 Qëllimi i shërbimit

Ky shërbim ka si qëllim mirëmbajtjen, përditesimet, integrimet, ndërtimin e raporteve specifike nga sistemi AMI dhe riparimin e cdo difekti të cilët mund të ndodhin gjatë operimit të këtij sistemi si dhe përmiresimin e proceseve aktuale të punës.

2. ANALIZA E SISTEMIT

Software-i i AMI, ofron mundësi për mbledhje të dhënave të regjistruara nga aparati matës smart EDM I ATLAS Mk10E/ EDM I ATLAS Mk6E si dhe cdo serie matësi smart EDM I ATLAS, ruajtje dhe shpërndarje të tyre, si dhe analizim dhe procesim sipas kërkesave të përdoruesit. Sistemi ka një licence për leximin e 50 mijë pikave të matjes dhe mundësi zgjerimi (scalable) deri në 500 mijë pika.

Paketa e aplikacioneve, e implementuar në Platformën AMI i ndodhur pranë OSHEE sh.a. është i organizuar në tre module:

- a. Moduli i mbledhjes së të dhënave;
- b. Moduli i ruajtjes së të dhënave në historik (baza e të dhënave);
- c. Moduli i shërbimit në web të të dhënave për përdoruesit, nëpërmjet web browser-ave standarte.

Në mënyrë skematike, operimi i platformës AMI paraqitet në figurën e mëposhtme:




Figura 1

2.1 Setup-i i sistemit

Realizon konfigurimin e matësve smart EDM I ATLAS Mk10E/EDMI ATLAS Mk6E dhe regjistrat e të dhënave për leximin në kohë reale dhe ruajtjen e tyre. Gjithashtu, ai realizon një lidhje online në network me matësat e sistemit, në mënyrë që në çdo kohë, të realizojë mundësi upgrade të firmware-ve nëpërmjet download-it ose të bëjë ndryshime konfiguruese tek matësat për funksionet e tyre.

2.2 Analiza

- Gjeneron raporte për konsumin e energjisë, kualitetin e parametrave dhe profilin e ngarkesave TOU për tarifat e programuara në matës.
- Regjistron, analizon dhe kategorizon sekuencat e ngjarjeve dhe alarmeve si dhe ndryshimet përkatëse në sistemin e parametrave të matjes.

- Analizon shpërndarjet e harmonikave dhe distorcioneve sag/swell, inbalancat si dhe vlerat minimale - maksimale dhe mesatare të rrymes, tensionit dhe parametrave të tjerë të energjisë.

2.3 Mbledhja e të dhënave

- Ruan të dhëna historike dhe ngjarje në një network database kompatibël ODBC.
- Interferon në hardware dhe software të sisteme të tjera nëpërmjet ModbusTM, RTU dhe UDP/IP, të internetit TCP/IP dhe është kompatibël me sistemet e menaxhimit të energjisë SCADA si dhe në të mund të përfshihen gjithashtu terminalët RTU dhe PLC
- Mundëson që të dhënat e matura të jenë të vlefshme dhe të eksportohen për një software tjetër, nëpërmjet File/DB dhe moduleve interface si dhe ka të integruar API (Application Programming Interface). Po kështu realizon edhe importin e të dhënave nga sisteme të tjera.
- Mënyra e mbledhjes së të dhënave mundësohet sipas dy logjikave: PUSH (matësat dërgojnë të dhëna drejt qendrës në mënyrë autonome) dhe POLL (lexim i menjëhershëm i të dhënave nga të gjithë matësat)

2.4 Komunikimi

- Sistemi i komunikimit me pikat matëse realizohet nëpërmjet rrjetit GSM / GPRS të ofruara nga një operator celular duke përdorur komunikimin IPsec VPN dhe mundësi me TCP nëpërmjet OPGW të Rrjetit të Telekomunikacionit të OSHEE sh.a.

3. OBJEKTIVAT DHE REZULTATET QE DUHET TE ARRIHEN

Rezultatet që duhet të arrihen përmes realizimit të kësaj kontrate shërbimi janë:

- Mirëmbajtje për Sistemin AMI duke përfshirë të gjitha modulet e sistemit
- Përditësimi për Sistemin AMI (Multidrive Web Manager) për shfaqjen e raportit të indexit
- Përditësimi periodik i sistemit AMI
- Kontrolli dhe përditësimi periodik i serverave
- Kontrolli i procedurave backup, restore
- Mbështetje teknike e përdoruesve gjatë situatave problematike duke realizuar verifikime dhe zgjidhje të problematikeve
- Rritjen e performancës së sistemit
- Kryerja në grup e proceseve ditore si import, export, filtrimet etj
- Integrimin e matësve ekzistues dhe të matësve të rinj EDM I ATLAS Mk10E/ EDM I ATLAS Mk6E

4. SUPOZIMET DHE RISQET

4.1 Supozimet

Faktori kyç i finalizimit me sukses të mirëmbajtjes është analizimi i kujdesshëm i proceseve ekzistuese të punës dhe i të gjithë sistemit aktual në tërësi. Bashkëpunimi me stafin e departamentit të IT-së së OSHEE Group sh.a do të lehtësojë mbledhjen e informacioneve të duhura rreth sistemit ekzistues.

4.2 Risqet

- Mosanalizimi i mirë i situatës aktuale të punës.
- Keqinterpretimi i faktorëve që ndikojnë në performancën e sistemit.
- Vonesa në procesin e analizës dhe reagimit në rast mosfunksionimi të sistemit.
- Mosmarrja në konsideratë e volumit të punës bazuar në numrin e përdoruesve në sistem

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1 Vendndodhja

Baza operative e mirëmbajtjes është në Tiranë. Sistemi është i instaluar në serverat ekzistues të OSHEE Group sh.a, të cilët janë të instaluar në datacentre-in e OSHEE. Më tepër detaje janë dhënë në seksionin e kërkesave teknike.

5.2 Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit të mirëmbajtjes do të jetë data e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik apo bashkimin e operatorëve fitues dhe periudha e mirëmbajtjes do të mbulojë 24 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

6. RAPORTIMI

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe në origjinal edhe 1 (një) kopje:

- **Raport Fillestar**, i cili duhet të dorëzohet 10 ditë nga fillimi i mirëmbajtjes së sistemit, ku të përshkruhen situata fillestare e sistemit, pritshmëritë etj.
- **Raport mujor**, i cili duhet të dorëzohet çdo muaj nga operatori ekonomik bazuar në standardin e kërkuar nga OSHEE.

- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të dorëzohet në fund të kontratës nga operatori ekonomik sipas standardit të kërkuar nga OSHEE.
- **Raporti final** duhet të dorëzohet në fund të kontratës nga operatori ekonomik bazuar në standardin e kërkuar nga OSHEE, raport i cili duhet të përfshijë komentet e pranuar nga palët në draft raportin përfundimtar.

7.NIVELET E SHERBIMIT(SLA)

Parametrat SLA përcaktojnë nivelin dhe qëllimin e shërbimit dhe mënyrën ose formën e realizimit të parametrave të paracaktuara. Parametrat e SLA monitorohen gjatë gjithë kohës së shërbimit dhe realizimi i tyre regjistrohet dhe vlerësohet. OSHEE sh.a merr rregullisht një Raport të Shërbimit, në bazë të të cilit do vlerësojë cilësinë dhe nivelin e shërbimeve të ofruara.

7.1 Koha e ofrimit të shërbimit (SLA)

Komponentet	Propozime
Koha e veprimeve kryesore	E hënë – E premte
Disponueshmëria e sistemit	99.9%
Gjuha e shërbimit	Anglisht ose Shqip
Ndjekja e çështjeve	Sistemi JIRA ose i ngjashëm
Raportim operacional mujor	Po
Statusi mujor i takimit (telekonferencë)	Po (rekomanduar)
Shërbime / ndryshime shtesë	Ofrohen në varësi të kërkesës dhe kategorizimit të defektit

Tabela në vijim përcakton kohëzgjatjen e propozuar dhe kohën e zgjidhjes për rikthimin në funksionimin e rregullt bazuar në mundësitë/ alternativat e SLA

Kategoria	Përshkrimi	Koha e përgjigjes	Koha e zgjidhjes
-----------	------------	-------------------	------------------

A- Kritik/ I Lartë	Shërbimi ose një pjesë thelbësore e tij nuk janë funksionale. Nuk ka asnjë mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	20 minuta	24 orë
B- Kritik i mesëm	Shërbimi nuk duhet të rikthehet menjëherë, por sa më shpejt që të jetë e mundur. Nuk ka zgjidhje permanente ose të përkohshme, por puna mund të shtyhet në rastet kur nuk ka pasoja financiare ose ekonomike.	30 minuta	48 orë
C- Kritik i ulët	Incidenti është thjesht i bezdisshëm, por jo i dëmshëm. Mund të jepet një zgjidhje e vazhdueshme ose e përkohshme në mënyrë që puna të vazhdojë.	30 minuta	15 ditë

Shënim: Operatori ekonomik është i detyruar për të zgjidhur problemet e raportuara në mënyrë të rregullt brenda afateve të mësipërme (koha llogaritet nga momenti i raportimit të problemit, në qoftë se është raportuar jashtë orarit të shërbimit, periudha llogaritet për fillimin e orarit të shërbimit në ditën pasardhëse të punës). Në ato raste, kur incidenti ose problem i raportuar, është urgjent (ku operimi i sistemit AMI prek OSHEE sh. a në afate të kuizuara kohore) shërbimi për zgjidhje duhet të jepet nga Operatori ekonomik sa më shpejt të jetë e mundur.

Shënim: Proceset e skedulimit të energjisë Long Term, D-1, intraday, janë procese të cilat kanë nevojë për suport 24 h në ditë, 7 ditë në javë. Një problem i sistemit që cenon këto procese sjell edhe bllokimin e skedulimit të energjisë. Në varësi të momentit që ndodh problemi përcaktohet edhe afati kohor për dhënien e suportit, i cili mund të kërkohej i menjëhershëm ose në intervale kohore 0.5 h ,1 h ,2 h deri në 24 h.

1. GRAFIKU I REALIZIMIT TE SHERBIMIT

VITI I PARE

Detyrat në muaj	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Raport Fillestar (10 ditë nga fillimi I kontratës)												
Raporti mujor (I shoqëruar në 3 kopje)												

VITI I DYTE

Detyrat në muaj	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Raporti mujor(I shoqëruar në 3 kopje)												
Drafti I raportit përfundimtar												
Raporti përfundimtar												

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 19.680.000 (Nentemdhjete milion e gjashtëqind e tetëdhjete mijë) leke pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti / enti kontraktor.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2022, 2023, 2024. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve gjithashtu të jenë të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga

data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 7,000,000 (Shtatë milion) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- *Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohe vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**”.*

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) dhe ISO 27001:2022 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (e vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve / mallrave / shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake

2.3.3 Operatori pjesëmarrës për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit duhet të vërtetojë se ka të punësuar ose me kontratë bashkëpunimi jo më pak se 2 (dy) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkencë kompjuterike) dhe 1 (një) punonjës në inxhinierinë elektrike ose ekuivalente, stafi të jetë i vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, diplomë përkatëse, Çertifikate perkatese si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, nga të cilat:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në implementim ose zhvillim të zgjidhjes softwerike e cila është përdorur për zhvillimin e sistemit që ofrohet.
- b. Të paktën 1 punonjës të certifikuar në administrimin e një prej RDBMS ose ekuivalente.

Një punonjës mund të jetë i certifikuar në një apo me shumë certifikata të percaktuara si mësipërme.

Për të përmbushur këte kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Lidhur me kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 30 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / distributori i Autorizuar ose certifikatën e të drejtave të autorit për shitjen e produkteve software dhe ofrimin e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurorimi në territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të prodhuesit / distributorit, autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit të autorizuar si: telefon,fax,e-mail,website, kjo është e nevojshme për Autoritein Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në mbështetje të përcaktimit të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të plotësojë sa më sipër.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----

Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacione për nënkontraktorin
- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË

KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
